



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:050046  
Datë: 07.05.2024  
Numri i dokumentit: 05663747

**Ac.nr.10337/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. S. nga fshati K. e E. Komuna e Novobërdës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M. M., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna Novobërdës- Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson me autorizim R. G. jurist nga Gjilani, objekti i kontestit kthim në punë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, C.nr.39/21, datë 03.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditësit D. S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë, C.nr.39/21, datë 03.08.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.39/21, datë 03.08.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D. S. nga fshati K. e E., me të cilën ka kërkuar që të konstatohet se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar tek e paditura Komuna e Novobërdës-Drejtoria e Arsimit në shkollën teknike “D. P.” në fshatin K. e E. si arsimtar i lëndës së biologjisë me gjysmë orari të punës dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të ardhurat personale për çdo muaj nga 200€, duke llogaritur nga data 01.10.2020 e tutje, e gjithë këtë me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i bartë secila pale veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe çështja të kthehet në rivendosje. Sipas tyre aktgjykimi nga gjykata e shkallës së parë është marrë bazuar në diskriminim, i cili ndalohet nga neni 5 i Ligjit të Punës. Më tej, aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban të gjitha elementet nga neni 160 i LPK-së.

E paditura ka ushtruar përgjigje në ankesë, përmes së cilës ka propozuar që të refuzohet ankesa, ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datën 17.03.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar të konstatohet se ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar tek e paditura si arsimtar i biologjisë me gjysmë orari, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë fillimisht ka administruar provat Vendimi nr.0146/16 i datës 29.12.2016, i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Certifikata e vlefshmërisë nr.4947/18 e datës 18.11.2016, e lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, certifikata e datës 30.01.2015, sa i përket trajnimit 21 ditor për zhvillimin e kapaciteteve në udhëheqjen arsimore, pasqyra financiare e lëshuar nga Raiffaisen Bank në emër të paditësit ku shihet se i njëjti gjatë muajit Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, të vitit 2020, ka pranuar pagë në shumë prej 201.03Euro, ankesa e datës 15.11.2020, dorëzuar në Komunën e Novobërdës, nga ana e paditësit. Pas vlerësimit të tyre, ka dhënë vlerësimin se pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në ligj, pasi që i njëjti me asnjë provë të vetme nuk e ka vërtetuar faktin tek e paditura nga viti 2013 është në marrëdhënie punë pa ndërprerë.

Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se duke mos e vërtetuar faktin se paditësi në vazhdimësi ka punuar tek e paditura nga viti 2013 e tutje, por siç thamë më lartë në këtë procedurë u vërtetua se paditësi është punësuar dhe ka marrë pagë nga e paditura nga muaji Mars deri muajin Tetor të vitit 2020, dhe ka pranuar pagë në shumë prej 201.03€, por nuk u vërtetuar se i njëjti ka punuar siç është pretenduar në padi (nga viti 2013), por edhe sikur të ishte vërtetuar një fakt i tillë, prap se prap neni 10.5 i Ligjit të Punës ka paraparë “Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore”. Prandaj, për këto arsye dhe bazuar në nenin 10.5 të Ligjit të Punës dhe neneve 319.1 lidhur me nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të palës së paditur se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë pasi kishte administruar provat, kishte arritur të vërtetoj gjendjen faktike për sa i përket fakteve të kualifikimit të paditësit fillimisht, më pas duke vërtetuar po ashtu se sipas gjendjes financiare nga llogaria bankare e paditësit, ai ka pranuar pagë vetëm për vitin 2020. Bazuar në provat që gjenden në shkresa të lëndës, e të cilat i ka administrua gjykata e shkallës së parë, nuk mund të gjendet ndonjë provë se realisht paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënie pune tek e paditura për një periudhë më të gjatë kohore. Bazuar në ato prova që janë propozuar nga përfaqësuesit e ndërgjyqësve, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur edhe arsyetimin, duke pasur parasysh, se kontesti i tillë udhëhiqet nga parimi se ndërgjyqësit janë ata që duhet të ofrojnë prova dhe propozime, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj në harmoni me nenin 10 par. 5 të Ligjit të Punës. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elabuaruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se Ligji i Punës Nr.03/L-212, në nenin 10 par. 5 parasheh *“Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit me të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.”*

Me qëllim aplikimi të kësaj norme, sipas vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, nuk është gjetur se paditësi ka punuar tek e paditura për dhjetë vite me kontrata të punës në kohë të caktuar, e cila është e paraparë si mundësi e themelimit të saj sipas Ligjit të Punës. Vihet në dukje paditësi kishte orientuar kontestin në drejtim të

vërtetimit se ai ka themeluar marrëdhënie pune, në vijimësi të këtij vlerësimi angazhimi i paditësit si mësimdhënës përgjatë vitit 2020 nuk përbën shkak që të vërtetohet se ai ka themeluar marrëdhënie pune me afat të pacaktuar. Themelimi i marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës, ka natyrë kontraktuale, e cila mund të jetë në afat të caktuar, apo të pacaktuar, kurse në rastin kontestues, nuk është vërtetuar se paditësi ka pasur një kontratë me të paditurën. Në anë tjetër, po ashtu nuk është vërtetuar angazhimi i paditësit si mësimdhënës për një periudhë prej 10 viteve, që më pas të konsiderohej se ai ka themeluar marrëdhënie pune me afat të pacaktuar. Së këndejmi objekt vlerësimi gjyqësor nuk është vlerësimi i ligjshmërisë së ndonjë vendimi, por i ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe vërtetimi se paditësi ka të themeluar marrëdhënie pune me afat të pacaktuar. Andaj, Gjykata e Apelit i pranon në tërësi qëndrimet dhe vlerësimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, me të cilat është vlerësuar se nuk është vërtetuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën.

Lidhur me pretendimin ankimor se gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur të aprovonte propozimin e paditësit dhe të sigurohej konkursi i vitit 2016-2017 në të cilin ka aplikuar paditësi, kjo gjykatë vlerëson si të pa bazuar dhe që nuk do të kishte ndikim në vendosjen përfundimtare, ngase nuk ka që objekt i çështjes nëse ka aplikuar paditësi në atë konkurs apo jo, porse objekt i çështjes ka qenë nëse paditësi ka punuar tek e paditura për një periudhë kohore, në mënyrë që të mund të konsiderohet se ai ka të drejtë në kërkesëpadinë tij që të vërtetohet se ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën.

Po ashtu rezultoi si i pa bazuar pretendimi ankimor për sa i përket diskriminimit, ngase në gjykimin në shkallë të parë nuk është ngritur si pretendim, po ashtu nuk ka argumentuar pretendimin e tij se i njëjti i është nënshkruar ndonjë formë të diskriminimit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.10337/2021, datë 07.08.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**